



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS SË GJAKOVËS

01. Nr. _____ /2020

Dt. 25.02.2020

Paneli përzgjedhës për zhvillimin procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Gjakovës, i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës me vendimin 01nr.011/01-24855, i datës 27.06.2018 duke u bazuar në nenin 73 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 4, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin Kompetencat e Komitetit Konsultative në Komuna shpallë këtë :

Konkurs

Për: Zgjedhjen e anëtarëve Komitetit Konsultativ për personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Gjakovës,.

Numri i anëtarëve : 5 - 7 me mandat 4 vjeçar, Kompensimi në proporcion me shumën e mëditjeve të komiteteve të përhershëm të Kuvendit të Komunës .

Kushtet :

Të jetë Banorë i Komunës së Gjakovës , të jetë njohës i fushës që ka të bëjë me personat me aftësi të Kufizuara , ose përfaqësues i organizatave përkatëse joqeveritare .

Dokumentet:

1. Kërkesën me CV.
2. Dokumentet e kualifikimeve (diploma)
- 3 Kopjen e letërnjoftimit.

Afati i paraqitjes së dokumentacionit është 15 dit kalendarike nga dita e publikimit të këtij konkursi , gjatë orarit zyrtar nga 08:00-16.00, në Zyrën Pritëse të Komunës së Gjakovës .

Vërejtje: Pas përzgjedhjes se listës së ngushtë nga Paneli përzgjedhës për zhvillimin procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara e njëjta do të dorëzohet në Kuvendin e Komunës për miratimi .

Për informata shtesë mund të drejtoheni në Zyrën për Informacion në Objektivin e Komunës së Gjakovës

